



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 36

Prishtinë, më 19.2.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje **morën pjesë**: Lulzim Zeneli, Myrvete Pantina, Berat Luzha, Heset Cakolli, Elhëme Hetemi, Naim Maloku, Ali Lajçi.

Munguan :Zulfi Merxha, Dragisha Miriç, Zef Morina, Selvie Halimi.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : zyrtarët nga MBPZHR: Shefki Zeqiri dhe Isah Rudaku, nga OSCE Blerim Vela dhe Maria Berishaj.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku

Mbledhjen e kryesoi : **Lulzim Zeneli**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Shqyrtimi i projektligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural,**
- 3. Grupet punuese për dy projektligje.**

Kryesuesi Lulzim Zeneli konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

2. Grupet Punuese

Kryesuesi Lulzim Zeneli propozoi fillimisht të caktohen grupet punuese për dy projektligjet e mbetura, pastaj të vazhdojë pika e radhës. U propozuan si vijon:

1. Projektligji për produktet Biocide do të shqyrtohet nga grupi punues e udhëhequr nga **Elhëme Hetemi**, ku mund të ftohen zyrtarët ose ekspertët kompetent nga udhëheqësja e grupit punues.

2. Projektligji për Rrezatimin Jonizues do të shqyrtohet nga grupi punues udhëhequr nga **Naim Maloku**, ndërsa në këtë takim do të ftohen edhe Heset Cakolli dhe parashtruesit e vërejtjeve në këtë projekt.

2. Shqyrtimi i projektligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural

Lulzim Zeneli ftoi zyrtarët e MBPZHR nëse kanë të shtojnë ndonjë risi për këtë projektligj. **Shefki Zeqiri** elaboroi shkurtimisht për rëndësinë e projektligjit dhe shprehu pajtimin parimor me vërejtjet e njësisë së standardizimit të Kuvendit lidhur me këtë projekt, propozoi të shqyrtohen nenet një nga një dhe të komentohen në tërësi vërejtjet.

Komisioni filloi shqyrtimin, por pasi momentalisht nuk kishte numër të mjaftueshëm për të vendosur, u sugjerua që në mbledhjen e radhës të miratohen vërejtjet si vijojnë:

Amendamenti 1

Në tërë tekstin e projektligjit:

-“Monitorimi” zëvendësohet me “Mbikëqyrja”,

-“Implementimi” zëvendësohet me “Zbatimi”,

- “Agjension” të shkruhet “Agjencion”,

- të përmirësohen disa gabime drejtshkrimore, p.sh. “trainimin” të shkruhet “trajnimin” etj,

- dy versionet tjera të ligjit duhet të përkthehen dhe të përshtaten versionit shqip, për shkak të numrit sa më të vogël të amendamenteve që do të hartohen.

Amendamenti 2

Neni 2, në paragrafin 1, fjala “rregullon” zëvendësohet me “përcakton”.

Amendamenti 3

Neni 3, në fillim fjalia riformulohet:

Shprehjet apo termat e përdorura ne këtë ligj kane këtë kuptim:

Tek përkufizimi “Masë e politikës bujqësore dhe zhvillimit rural”, në fund shprehja “**me këtë ligj**” do të zëvendësoi shprehjen “me nenin 16 të këtij ligji”.

Amendamenti 4

Neni 4, paragrafi 4, pika 1.4 riformulohet :

“Cilësia e prodhimeve të ushqimit duke garantuar që zinxhiri ushqimor është i një cilësie të qëndrueshme dhe i plotëson standardet e përcaktuara.”

Amendamenti 5

Neni 5 paragrafi 2 (dilema a të mbetet fjala “përgjegjës për Bujqësinë”) dhe **Neni 6 paragrafi 1** (me dilemën sa vjeçare të jetë plani) mbetet për diskutim dhe propozim nga MBPZHR për riformulim .

Paragrafi 2 dhe 3 i nenit 6 bashkohen duke fshirë tekstin “3. Plani i veprimit përfshinë:”.

Amendamenti 6

Neni 7, titulli riformulohet :”**Parimet mbi të cilat bazohen masat e politikës bujqësore**”.

Amendamenti 7

Neni 15, titulli riformulohet :”**Shfrytëzimi dhe përdorimi i informatave nga bazat tjera të të dhënave**”.

Amendamenti 8

Neni 18, paragrafi 2, të deklarohe MBPZHR të fshihet apo të mbetet.

Amendamenti 9

Neni 19, paragrafi 1, riformulohet:

“Për përfituesit nga masat e politikës së bujqësisë dhe të zhvillimit rural, është i detyrueshëm mbajtja e kontabilitetit. Fermat jo përfituese mund të mbajnë kontabilitet në baza vullnetare”.

Amendamenti 10

Neni 24, të sqarohet nga MBPZHR për mbledhjen e radhës.

Amendamenti 11

Neni 29, paragrafi 1 të rishikohet nga MBPZHR (dilema rreth kryeshefit), dhe tek **Neni 30** të shikohet mundësia e ndërrimit të afateve, 18 të bëhet 12, ndërsa në paragrafin 2 , numri dy (2) të bëhet 12.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,20, mbledhja e radhës do të mbahet më 24.2.2009 në orën 13,00 kur do ti shqyrtoi komisioni përfundimisht vërejtjet e sotme, ndërsa grupi punues për projektligjin e rrezatimit jonizues do të takohet më 25.2.2009 në orën 12,00.

Mbledhja përfundoi në orën 14,20.

Kryetari i Komisionit,
Lulzim Zeneli